



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality




Kuvendi Komunal i Kamenicës

Datë: 19.03.2026

Mbështetur në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 pika 1.2, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës,

Kryesuesja e Kuvendit me datë: 19.03.2026 :

T H Ë R R E T



Mbledhjen e III-të, të rregullt të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Premte** me datë: **27.03.2026**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë,

R E N D I T E

1. **Betimi i Anëtarëve të Kuvendit Komunal, Hasan Krasniqi, Valmir Ramadani, Leonita Mavriqi.**
2. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 27.02.2026.**
3. **Pyetje legjislativitet drejtuar ekzekutivit.**
4. **Shqyrtimi i Raportit Financiar Buxhetor 1 Janar – 31 Dhjetor 2025.**
5. **Shqyrtimi i Raporti Periodik për zbatimin e rekomandimeve nga Zyra Kombëtare e Auditimit.**
6. **Kërkesë nga MAPL për rishqyrtim të Vendimit Sh.01 Nr. 3069 për miratimin e PZHK 2025-2033**
7. **Propozim vendim për Shpallje me Interes të Përgjithshëm Publik.**
8. **Propozim vendim për formimin e Komisionit për Inicimin dhe zhvillimin e procedurave dhe vlerësimin e propozimeve për ndryshimin e Stemës së Komunës së Kamenicës.**
9. **Propozim vendim për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB).**
10. **Propozim vendim për emërtimin e Palestrës së Sportit.**
11. **Propozim vendim për miratimin e raporteve për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.**
12. **Propozim vendim për rifreskimin e listës rezervë të emertimeve të rrugëve, rrugicave dhe hapësirave publike në Komunën Kamenicës**
13. **Të ndryshme.**

Arbore BEQIRAJ FERA

Kryesuese e Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e II-të, e rregullt e Kuvendit të Komunës së Kamenicës

Mbledhja u mbajt në objektin e komunës më datë: 27.02.2026 dhe filloj ora 10:10. Në mbledhje përveç delegatëve të kuvendit, të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, nënkryetarja, disa drejtor të drejtorive komunale, Shërbimi profesional i kuvendit, përkthyesi, zyra e informimit, zyrtar komunal, përfaqësues të OSBE-së. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Kuvendit të Komunës, znj. Arbnore Beqiraj Fera, e cila për mbledhje propozoi këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 30.01.2026.
2. Pyetje legjislativ të drejtuar ekzekutiv.
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026.
4. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Sh.01 Nr. 21967 i datës 12.08.2025 për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësrejtoreve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.
5. Të ndryshme.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, I nderuari Kryetar i Komunës z. Kadri Rahimaj, e nderuara nënkryetare Arta Bajralija.

Të nderuar anëtar dhe anëtare të Kuvendit Komunal

Të nderuar të pranishëm të tjerë mirë se keni ardhur në mbledhjen e II-të të rregullt të Kuvendit Komunal.

Fillimisht Konstatohet se kemi korum të mjaftueshëm për hapjen e mbledhjes, materialin dhe rendin e ditës e keni marrë me kohë

A keni propozime për rend dite ? Fjala për Kryetarin

Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës, përshëndetje për të gjithë, faleminderit Kryesuese. I kemi dy propozim vendime në fakt njëri është propozim ndërsa tjetri është në formë rekomandimi por që kuvendi duhet të mer vendim.

1. Propozimi i parë ka të bëjë me **Shpallje me Interesë të Përgjithshëm Publik**, për një pronë e cila është në pronësi të pronës shoqërore N.T.SH. QENDRESA, të cilat janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovare e Privatizimit, bëhet fjalë për lokale me sipërfaqe të përgjithshme 139 m², këto lokale mi qujt lokale por janë krejt të shkatruara gjenden përball Kishës ortodokse, prona është e komunës por objektet janë nën menaxhimin e Agjencionit Kosovar të Privatizimit, para se këto ti nënshktohen procesit të likuidimit ne kërkojmë që të mbeten në pronësi të Komunës së Kamenicës. Sa i përket propozimit të dytë ka të bëjë me
2. **Propozim vendim për Zgjedhjen e delegatëve të Komunës së Kamenicës në Kuvendin e Asocacionit të Komunave të Kosovës (AKK)**, rëndomt në secilin mandat duhet të zgjedhen delegat, me automatizëm shkon Kryetari i Komunës dhe Kryesuesja, si dhe një delegat të propozohet nga subjekti i cili në këtë rast është LVV, kjo shkresë na ka ardhur nga AKK me vonesë dhe nuk ka pasur mundësi mu përfshir në rend dite, sidoqoft nëse e konsideroni mund ti trajtojm dyjat.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, i hedhin në votim këto propozime
Kush është Për që këto pika të hyjnë në rend dite ?

Për 9

Kundër 0

Abstenim 0

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni propozime të tjera, atëherë
E hedhim në votim për miratim rendin e ditës në tërësi ?

Për 14

Kundër 0

Abstenim 0

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga Mbledhja e mbajtur me datë**

30.01.2026

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal - jemi në pikën e parë të rendit të ditës është Shqyrtimi dhe Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt.

30.01.2026,

A keni vërejtje apo diskutime rreth procesverbalit? Atëherë nëse jo e hedhim në votim

Kush është për miratimin e procesverbalit?

Për 14

Kundër 0

Abstenim 0

2. Pyetje legjislativit drejtuar ekzekutivit

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi në pikën e dytë Pyetje legjislativi drejtuar ekzekutivit. A keni pyetje ? Fjala për Djellonë Rudhani.

Djellonë Rudhani, Faleminderit. Të nderuar përfaqësues të ekzekutivit, të nderuar koleg të Kuvendit, të nderuar pjesëmarrës, meqënëse jam vetë pjesë e fushës së Arsimit dua ti paraqesë disa pyetje në lidhje me fushën e Arsimit në Komunën tonë.

1. A kanë shkollat staf të mjaftueshëm profesional si psikologë, pedagogë specialë dhe asistentë për të mbështetur mësimdhënësit dhe nxënësit me nevoja të veçanta, dhe cili është plani për rritjen e tyre në bazë të nevojave reale në shkolla ?

2.Duke pasur parasysh zhvillimin e hovshëm të teknologjisë, a ka të planifikuara trajnime për mësimdhënësit që të ju mundësojnë ti përballojnë sfidat reale për përdorimin efektiv të teknologjisë në mësim

3. Në shkollat ku po vijohet mësimet nxënësit në Shkollat "Fan Nolit" dhe "Dëshmorëve të Kombit" janë evidentuar shqetësime nga prindërit në lidhje me një aromë e pakëndshme sidomos në katin e 3-të, a do të ndërmerren inspektime dhe masa konkrete për të siguruar një ambient të shëndetshëm dhe të sigurt për nxënësit dhe stafin? Faleminderit!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Faleminderit Djellona, fjala për Kryetarin.

Kadri Rahimaj- Kryetari i Komunës së Kamenicës, Faleminderit Djellona. DKA brenda kopetencave të saja ashtu siq janë të specifikume edhe në Ligjin për Arsim Parauniversitar, Stafi mbështetës tashmë është politikë e re e cila inicohet nga MASHTI, siqë janë Asistent për Fëmijë me Nevoja të veçanta ka 10 pozita të dedikuara për këtë staf, ndërsa Psikologët dhe Pedagogët që janë asktualisht në shkolla të Komunës sonë, drejtorja ka filluar të bëjë

shpërndarjen e tyre sipas nevojës nëpër institucione shkollore. DKA ka marrë edhe masa tjera duke angazhuar edhe staf mbështetës për fëmijë të cilët mund të kenë ngecje në zhvillim. Sa i përket Trajnimeve për stafin në shumë fusha që janë trajnuar të kërkojnë ndjesë që nuk e di sakt se në cilat fusha janë të trajnuar, por në mënyrë periodike në bashkëpunim me organizata të ndryshme por edhe me politika që zhvillohen nga MASHTI, nuk e di nëse kanë pasur të bëjnë në fushën e teknologjisë mirëpo do ta shihim në të ardhmen. Ajo që na intereson që mësimdhënësit të jenë në kohë me gjithë kërkesat të cilat dalin edhe nga kurikulat dhe proceset që kërkohen me ligj.

Shëndeti i Shkollës përbrenda të themi për ne është primare, këtu po punojmë ngusht edhe me DKA që ne ta bëjmë një skanim të plotë të të gjitha shkollave, një pasqyrë të qartë për të gjitha shkollat dhe nevojat e tyre në mënyrë që ne mund të intervenojmë dhe më pas Komuna do ndaj fonde për secilin problem veç e veç. Për arsimin e pakëndshëm ne mund të kërkojmë nga Drejtorin e Arsimit që të delegoj dikë të bëjë inspektime që kjo arsimi vjen nga moskujdesi i duhur i mirëmbajtjesve të shkollave apo ka probleme të tjera teknike që duhet të sanohen me kontratat që janë aktuale.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Faleminderit Kryetar. A kemi diskutime apo pyetje të tjera? fjala për Granit Berisha

Granit Berisha, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Në mbledhjen e fundit të KPF-së, unë kam kam shfrytëzuar rastin për ta kërkuar një raport të detajuar të Investimeve Kapitale, të progresit në raport me këto investime, realisht pritshmërit e mija kanë qenë që ky raport të na ofrohet para mbledhjes së Kuvendit në mënyrë që ne të kemi mundësinë ta analizojmë paraprakisht dhe ta zhvillojmë një debat në raport me këtë Raport, mirëpo të njëjtin nuk e kam pranuar dhe deshta të marr si informacion se a do ta marrim sot apo si do të vazhdojë tutje? Faleminderit shumë!

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Kryetarin.

Kadri Rahimaj-Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit shumë z. Berisha, neve Administrata e Kuvendit na ka dërguar kërkesën tuaj, sido qoftë pak sa po zgjerohem në këtë diskutim, në radhë të parë duhet ti kuptojmë pozicionet e secilit prej nesh, që Kuvendi është një organ mbikqyrës kjo as nuk diskutohet dhe nuk e vendosim në dyshim, që ekzekutivi është i ndarë nga Kuvendi po e po, Raporti i Kryetarit është diskutuar në mbledhje më herët edhe kjo është fakt, e i cili nuk është komentuar e as nuk është pyetur për asgjë, që të gjitha kontratat janë publike nuk e vëm në dyshim ngase janë shumë të sigurt, vetë Buxheti është publik po ashtu, pra ne jemi transparent me atë që ofrojmë Kuvendit, raportojmë në çdo tre (3) muaj për zhvillimet e komunës në raport me shpenzimet buxhetore, prandaj të gjitha këto

që i keni kërkuar janë veqse publike dhe të ardhura në Kuvend, por konsideroj që Drejtori i raporton Kryetarit e Kryetari raporton tek Kuvendi, qysh e bëjmë rëndom dhe jemi të obliguar Ligjërish të këtë gjë, ne duhet ta shohim vetën bashkëpunëtor, e kam thënë me gjasë edhe në mandatin e kaluar por ju nuk keni qenë, kjo është sallë e kuvendit dhe nuk është sallë gjyqi, ku njëri-tjetrit ja bëjmë herë Avokatin, herë Prokurorin e herë Gjyqtarin, unë jam shumë i interesuar për qështjet të cilat ju e keni marrë besimin e qytetarëve me i ngrit këtu, për qështjet të cilat jemi të obliguar Ligjërish të bëjmë ne do ta bëjmë, në periudha të sakta kohore, do të jemi shumë transparent para secilit delegat ashtu siq jemi para secilit qytetar. Nuk mundemi që në mungesë të gadishmërisë së ndonjë asambleisti në njërin nga seancat të kërkoj dokumente veçmas, këtu janë kapacitetet e limitume përderisa dokumentet janë sjell jo më larg se në mbledhjen e kaluar. Unë besoj që roli i asamblesitit të jetë mbrojtja e interesit të qytetarëve, ndërsa ajo që mund të gjeni gjatë rrugës së qeverisjes sonë, jam shumë i gatshëm edhe të pranoj gabimin por edhe ta ndëshkojm gabimin nëse vërehet se ai gabim është i qëllimshëm dhe besoj që kësisoj i kontribojmë edhe frymës së komunitet që ka Kamenica.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar, një replik e shkurtër nga Granit Berisha

Granit Berisha, faleminderit Kryesuese. Në frymën e bashkëpunimit dhe mbarvajtjes së punës në Kuvend secili nga ne jemi të vedishëm për pozicionet që kemi, por njëkohsisht edhe për autorizimet që kemi, nuk mendoj që ka diçka të keqe të kërkohej Raporti, sepse janë fonde publike që menaxhohet ekzekutivi, në këtë rast ju. Është e vërtet që raporti ka qenë në kuvend por ka qenë më i përgjithshëm, kërkesa ime ka qenë ta kemi një pasqyrë të qart të Investimeve Kapitale si dhe me progresin e kontratave të cilat nuk paraqiten dhe nuk kanë qenë të paraqitura në Raport tuajin, sidoqoft unë ju falenderoj për gadishmërin tuaj për mos ta sjell këtë raport, nuk mendoj që ka diçka të keqe dhe nuk ka tendencë por ida ishte ta kem një pasqyrë të qart se deri ku kemi arritur me Investime Kapitale dhe cili është progresi në këto kontrata. Faleminderit shumë!

Arbnore Beqiraj Fera – Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Kryetarin.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Raportet të cilat neve na obligon Ligji vijnë në kuvend në baza periodike të rregullta, edhe Raportet Financiare edhe Raporti i Punës së Kryetarit përfshirë gjitha drejtoritë dhe sektorët, të gjitha këto janë kryer në një seancë më herët, nëse ju nuk e keni lexuar është problem të cilin po e shfaqeni tani, nëse i keni lexuar dhe nuk i keni kuptuar ne mundemi me dhanë informata shtesë ose edhe sqarime shtesë, por në një seancë më herët janë diskutuar, në Qershor prap do e sjellim Raportin e Kryetarit, në Mars do e sjellim Raportin Financiar ku përveç vlerave të sakta edhe përqindjet i keni aty tek

shpenzimet e paras publike, këto kanë qenë në kuvend por është dasht me marë mundin për ti lexuar, por nëse mendoni që janë voluminozë ne i shkurrejmë dhe pak.

Arbnore Beqiraj Fera – Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Granit Berishën për diçka të shkurt.

Granit Berisha, Kam diçka të rëndësishme një (1) fjali, Kryetar po besoj që ne kemi me qenë këtu në katër (4) vjeqarin e ardhshëm është mirë dhe kisha kërkuar që të gjithëve ta ruajm nivelin a lexojm dhe a kuptojm nuk ju takon juve.

Arbnore Beqiraj Fera – Kryesuese e Kuvendit Komunal, në rregull Granit ke kaluar limitin, fjala për Jeton Biqkaj.

Jeton Biqkaj, Faleminderit dhe përshëndetje për të gjithë. Unë e kam një pyetje për Sheshin ku ka mrrri dhe pse nuk po përfundon, si dhe qështja e Shkollës Fan Noli si dhe një pyetje Kryetar a e keni kompletuar ekzekutivin ende nga postimet ne rrjetet sociale po i shohim një nga një, urime për nënkryetaren ? Sa i përket ekzekutivit a janë emrat e gjithë drejtorëve ?

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit Jeton, po filloj të jap përgjigje nga e fundit se po më pëlqen më shumë, po është kompletuar ekzekutivi me drejtor të rinjë e për kureshtje po e publikojm nga një, ne jemi duke punuar. Qështja e Fan Nolit, jeni dhe ju dëshmitar se aty puna po zhvillohet edhe po ecin mirl e mbarë, siqë e dini Ministria e Arsimit e ka shpallur porcedurën dhe e menaxhon projektin, ajo që ne bëjmë inspektive herë pas here edhe prej meje edhe nga drejtorët, përshkak që objekti është në qendër mund të vërejmë se po bëhen punime me intenzitet, ndërsa Bulevardi është kontrata aktive dhe punët do të rifillojnë sapo të kemi kushte klimatike dhe kjo do të mer fund. Po emrat janë me vendim, janë të kryer.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar, a kemi pyetje të tjera për diskutim? Atëherë shkojmë te pika e 3-të

3. Shqyrtimi i dhe aprovimi i Planit të Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2026

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, Pika e tretë ka të bëjë me Planin e Punës së Kuvendit Komunal është i hartuar në përputhje me Ligjin për vetqeverisje lokale, statutin e Komunës. Qëllimi i Planit është organizimi i punës së Kuvendit për vitin 2026, planifikimi i mbledhjeve dhe trajtimi me kohë i çështjeve në kompetencë të tij. Në këtë Plan janë planifikuar 12 mbledhje të rregullta të Kuvendit, data e sakt përcaktohet në thirrjen time si kryesuese. Plani është një dokument orientues dhe mund të plotësohet apo ndryshohet gjatë vitit varsisht nga nevoja dhe çështjet që paraqiten për shqyrtim.

A keni diskutime rreth Planit të Punës së Kuvendit Komunal, nëse jo e hedhim në votim

Kush është për miratimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2026

Për 14

Kundër 0

Abstenim 0, miratohet.

4. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Sh. 01 Nr. 21967 i dt. 12.08.2025 për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendsdrejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e katërt që ka të bëjë me Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit Sh. 01 Nr. 21967 i dt.

12.08.2025 për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendsdrejtorëve në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Kamenicës, fjalën Kryetari.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit shumë kryesuese, në legjislaturën e kaluar Kuvendi Komunal ka marrë vendim për formimin e komisionit për zgjedhjen e drejtorëve të shkollave, nëse nuk gabojmë në gusht dhe Ligjshmëria e këtij vendimi është tej zgjatur nga Ministrit e linjës, dhe krejt në fund pas 2-3 shkresave zyrtare që ne i kemi drejtuar Ministrive është pranuar Ligjshmëria e këtij vendimi. Ne e shohim të nevojshëm plotësim ndryshimin ngase në atë kohë është votuar që të jenë dy anëtar për zgjedhjen e drejtorëve dhe një e dergon MASHTI, anëtar ka qenë Ramadan Guda që është zyrtar në DKA si dhe Selami Klaiqi drejtor që këto i përcakton vet ligji, tani Selami Klaiqi ka marrë pozitë politike është Drejtor i Arsimit në Komunë dhe nuk ka të drejtë të jetë anëtar i këtij komisioni, e ne po kërkojmë që z. Klaiqi të zëvendsohet me drejtoreshën Bilkizare Kryeziu.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar a kemi diskutime rreth kësaj pike ? nëse jo e hedhim në votim

Kush është për miratimin e kësaj pike ?

Për 13

Kundër 0

Abstenim 1, miratohet.

5. Propozim vendim për Shpallje me Interesë të Përgjithshëm Publik

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika e pestë Propozim vendim për Shpallje me Interesë të Përgjithshëm Publik, fjala për Kryetarin

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, atë që e thash për këtë propozim që të përfshihet në rend dite, bëhet fjalë për sipërfaqe të lokaleve shumë të amortizuara por që ne duam të mbesin në pronësi publike, me sipërfaqe prej 139 m², këto lokale janë në pronësi të NTSH Qendresa po që aktualisht menaxhohen nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit, mos me u përfshi në valën e likuidimit ne kërkojmë që këto lokale të mbesin në pronësi të Komunës, përmes vendimit për të Shpallë Interes të Përgjithshëm Publik.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar a kemi diskutime rreth kësaj pike ? fjala për Magbule Kastrati

Magbule Kastrati, Faleminderit Kryesuese, përshëndetje për të gjithë. Desha ta pyes Kryetarin ; A është duke u zhvillu diqka te këto lokale dhe nuk po e di për cilat po bëhet fjalë, sakt ?

Kadri Rahimaj- Kryetar i Komunës së Kamenicës, aty nuk është duke u punuar asgjë, ato quhen lokale në letra, janë përball Kishës Ortodokse, nuk kanë dyer e as dritare ml shumë duken si garazha.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, diskutime tjera a kemi ? nëse jo e hedhim në votim

Kush është për miratimin e këtij propozim vendimi ?

Për 12

Kundor 0

Abstenim 2, miratohet.

6. Propozim vendim për zgjedhjen delegatëve të Komunës së Kamenicës në Kuvendin e Asocacionit të Komunave të Kosovës (AKK),

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, jemi te pika gjashtë e rendit të ditës Propozim vendim për zgjedhjen e delegatëve të Komunës së Kamenicës në Kuvendin e Asocacionit të Komunave të Kosovës (AKK), fjala për kryetarin.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, e thash në fillim që në secilën Legjislaturë të re, duhet përfaqësues të Kuvendeve Komunale në përfaqësim të AKK-së, janë tre anëtar Kryetari, Kryesuesja dhe një anëtar i Kuvendit, ne kemi këtë si propozim.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, fjala për Liridon Kastratin Liridon Kastarati, përshëndetje për të gjithë, LVV për Asocacionin e Komunave të Kosovës, propozojmë Berat Dërmaku-n.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, vetëm se harrova të potencojë që nuk ka obligim as financiar e as politikë për këta që do përfshihen në këtë vendim, e as nuk do i nënshtrohet Ligjshmërisë ky vendimi, për arsyeje që Asocacioni është një OJQ dhe secila komunë në bazë të vullnetit përfshihet në Asocacion.

Arbnore Beqiraj Fera- Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diktume, nëse jo atëherë e hedhim në votim

Kush është për miratim ?

Për 14

Kundër 0

Abstenim 0

7. Të ndryshme

Arbnore Beqiraj Fera – Kryesuese e Kuvendit Komunal, a keni diskutime në kuadër të pikës të ndryshme, fjala për Jeton Zylfiu.

Jeton Zylfiu, Përshëndetje për të gjithë. Unë kam një propozim në lidhje me fatkeqësitë e mundshme, fatkeqësitë natyrore por edhe të tjera, mendoj që kemi për obligim ta kemi një planë për situata emergjente, kërkoj që të caktohet një ekip nga ekzekutivi, unë nga eksperiencia ime që kam jam në gjendje gatishmërie ta mbështesë këtë ekip, ky plan na obligon edhe në bazë të Ligjit me nr. 04/L- 27 për mbrojtje dhe shpëtim, unë kisha propozuar që ta bëjmë një plan ashtu siç duhet, besoni që do ndikoj shumë dhe do shpëtoj shumë jeta, kur kemi plan edhe shpejtësia e reagimit është më e shpejt. Faleminderit!

Arbnore Beqiraj Fera – Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Jeton, fjala për Kryetarin.

Kadri Rahimaj – Kryetar i Komunës së Kamenicës, Faleminderit shumë Jeton , ne e vlerësojmë gatishmërinë tuaj që asamblisti të ndihmojë pjesën e ekzekutivit, në këso plane

strategjike të nevojshme dhe shumë të rëndësishme edhe për institucionin por në radhë të parë për qytetarin, ne jemi të gatshëm që Komuna të dij të reagoj në raste emergjente apo fatkeqsive natyrore, jemi të vedishëm që kjo nuk mund pa nivelin e ekspertizës që ju veç tashmë e posedoni nga eksperienca juaj e gjatë, e cila mund të përkthehet në një plan më të detajuar bashkë me drejtorit përkatëse dhe zyrtarët komunal në ato drejtori, në mënyrë që të bëhet punë konkrete në të ardhmen.

Arbnore Beqiraj Fera – Kryesuese e Kuvendit Komunal, faleminderit Kryetar, a keni diskutime të tjera, nëse jo.

Konstatojmë të mbyllur mbledhjen sotme.

Takimi mbyllet në orën 10:40

Procesmbajtëse


Violeta Krasniqi

Kryesuese e Kuvendit Komunal



Arbnore BEQIRAJ FERA





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

REFERENC-Ë:	SH.Z nr. _____			
PËR/ZA/TO:	Kryetarin e Komunës z.Kadri Rahimaj Kryesuesen e Kuvendit Komunal znj.Arbnore Beqirja-Fera			
CC:				
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtores e DBF-së znj.Ardita Dërmaku			
NGA/OD/FROM:	z.Selami Zylfiu-u.d .Udhëheqës për Buxhet dhe Financa z.Labinot Dërmaku- Zyrtar Kryesor Financiar			
TEMA/SUBJEKAT/ SUBJECT:				
Nr. i Zyrës:		Lokacioni:		
Br. Kancelarije:		Lokacija:		
Room No:		Extencion:	Data:	10.03.2026


Të nderuar,

Në bazë të Ligjit për Menagjimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë neni 46, 46.2 Kryetari i komunës duhet të përgatitë dhe t'i dorëzojë kuvendit komunal një raport përfundimtar përmbledhës buxhetor i cili përmban të dhënat e përcaktuara në neni 46.1 për vitin fiskal buxhetor përfunduar.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



RAPORTI FINANCIAR BUXHETOR I KOMUNËS KAMENICËS PËR PERIUDHËN 1 Janar– 31 Dhjetor 2025

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

KAMENICË, Janar 2026

www.kamenica-komuna.org

Përmbajtja

1.Hyrje.....	3
1.1 Performanca e të hyrave.....	3
1.2 Performanca e shpenzimeve.....	3
Tabela 1. Të hyrat vetanake për vitet 2023,2024 dhe 2025.....	4-5
Grafiku1.Të hyrat vetanake për vitet 2023,2024,2025.....	5
Tabela 2. Të hyrat vetanake për vitin 2025 sipas programeve dhe llojit të të hyrave.....	6
Grafiku 2.Të hyrat vetanake 2025 sipas muajve.....	7
Tabela 3. Buxheti sipas kategorive ekonomike 2024-2025.....	8
Grafiku 3. Buxheti sipas kategorive ekonomike 2024/2025.....	8
Tabela 4. Buxheti sipas fondeve burimore 2024/2025.....	9
Grafiku 4. Buxheti sipas burimit të fondeve 2024/2025.....	9
Tabela 5. Shpenzimi i buxhetit sipas fondeve burimore 2024-2025.....	9
Tabela 6. Lëvizja se buxhetit Janar-Dhjetor 2025.....	10
Tabela 7. Realizimi i buxhetit ispas kategorive ekonomike 2024-2025.....	10
Tabela 8.Shepnzimet sipas Kategorive ekonomike 2024-2025.....	11-13
Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara.....	14
Neni 18 Detyrimet kontingjente	14
Neni 25 Rexhistri i punëtorëve sipas listës së pagave.....	15
Neni 21 Raport mbi të hyrat vetanake të pa shpenzuara.....	16
Tabela 9. Projektet kapitale nga fondi burimor 10	17-18
Tabela 10. Projektet sipas fondit burimor 21-Të hyrat vetanake.....	19
Tabela 11. Projektet sipas fondit burimor 22- Të hyrat e bartura.....	20
Tabela 12. Projektet sipas fondit burimor 31- Të hyrat nga donatorët e brendshëm.....	21
Tabela 13. Projektet sipas Fondit Burimor 32-93 Të Hyrat nga Donatorët e Jashtëm.....	22
Tabela 14. Raporti i shpenzimeve për vitin 2025 sipas drejtorive.....	23-27

1. Hyrje

Raporti vjetor buxhetor, për periudhën janar-dhejtor 2025, është përgaditur në pajtim me dispozitat e nenit 45, paragrafët: 45.2, 45.4 dhe 46.1 të Ligjit ,nr.03/L-048, për menaxhimin e Financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i përgaditur nga Drejtoria për Buxhetit dhe Kryetarit të Komunës, mbulon vitin fiskal 2025 dhe paraqet informatën e përcaktuar, që ka të bëjë me arkëtimin, shpenzimet, të dhënat mbi investimet dhe detyrimet.

1.1 Performanca e të hyrave

Si rezultat, gjithësejt të hyrat vetanake duke përfshirë edhe donacionet në Komunën e Kamenicës gjatë vitit 2025 janë realizuar 946,406,98€ që paraqet 83.45% të realizimit në raport me planifikimin prej 1,134,072.00€.

Të hyrat Tatimore janë 430,993.84€ që paraqet një rritje 43.60% në krahasim me vitin 2024 që ishin 300,251.75€ ndërsa të hyrat jo tatimore 511,813.14€, me një rritje prej 12.86% krahasuar me vitin 2024 që kanë qenë 453,518.02€ e që më poshtë gjëni të shpalosura sipas nënkodeve ekonomike.

1.2 Performanca e shpenzimeve

Shpenzimet buxhetore përgjat vitit 2025 në total kanë qenë 15,612,453.06€ me një diferencë 0.51% më të vogla krahasuar me vitin paraprak ose në shumë 80,613.24 €.

❖ **Shpenzimet për paga dhe medijtje**, shënuan vlerën 9,450,840.43€, duke arritur normën e ekzekutimit 99.87% krahasuar me vlerën e përgjithëshme të buxhetit 9,463,347.08€ për këtë kategori. Shpenzimet për paga përgjat periudhës raportuese të njëjt nga viti 2024 ishin më të ulëta për 11.82% ky process është pasojë e ndryshimit të ligjit për pagat në periudha të caktuara, dhe një pjesë e pagave është mbuluar nga Qeveria sipas vendimit nr.03/261 të dt.05.06.2025 në shumë 277,912.08€

❖ **Shpenzimet për mallra dhe shërbime**, shënuan vlerën 2,347,995.56€, duke arritur normën e realizimit të buxhetit 95.63% krahasuar me buxhetin e tërsishëm të Komunes, respektivisht nga buxheti final 2,455,403.95€ për këtë kategori të shpenzimeve. Vlenë të theksohet se ka një rritje nga viti paraprak 17.35% ose në vlerë 347,179.98 euro, dhe pjesëmarrja në raport me buxhetin e tërsishëm për këtë kategori është 14.65%

❖ **Shpenzimet komunale**, kanë arritur normën e ekzekutimit prej 99.96% apo në shumë 261,892.80€, në raport me buxhetin final paraqesin po thuaj 100% të planifikimit për këtë kategori ekonomike. Në raport me vitin paraprak ka një rritje të shpenzimeve në shumë 19,617.44 euro. Ky ndryshim vjen si rezultat i ndryshimeve të çmimeve në treg dhe zgjerimit të rrjetit të ndriçimit publik.

❖ **Shpenzimet në subvencione dhe transfere**, në këtë kategori të shpenzimeve norma e ekzekutimit ka arritur 883,690.94€ ose 99.85% nga planifikimi për vitin 2025 që ishte 885,000.25€, që nënkupton se ka një rritje nga krahasim me vitin 2024 në shumë prej 128,404.21 ose 16.97%

Pjesëmarrja e subvencioneve dhe transfereve në raport me buxhetin e tërsishëm ka qenë 5.52%

❖ **Shpenzimet Kapitale**, arritën vlerën 2,668,033.33€ që paraqet realizim prej 90.04% nga buxheti i planifikuar për investime kapitale që ishin në shumë prej 2,963,032.92€, dhe ka një rritje të ndjeshme në raport me vitin 2024 në shumë 692,037.34€ ose shprehur në përqindje paraqet 35.02% më shumë. Kjo rritje vjen edhe si rezultat i vendimeve gjyqsore përmbarimore të cilat ishin 725,558.20€ Pjesëmarrje e investimeve kapitale në raport me buxhetin e tërsishëm ishte 18.49% ose në shumë prej 2,963,032.92€.


Tabela 1. Të hyrat vetanake për vitet 2023,2024 dhe 2025 sipas nënkodeve ekonomike/krahasimi

Kodi Ekonomik	Përshkrimi	2023	2024	2025	KRAHAS IMI 2025-2023	KRAHAS IMI 2025-2024
	1. GJITHSEJ PRANIMET DIREKTE +INDIREKTE	1,966,725.40	1,664,701.57	1,641,530.45	83.47	98.61
	1. GJITHSEJ PRANIMET DIREKTE	1,781,348.65	1,431,400.73	1,333,162.45	74.84	93.14
	1.1. Të hyrat nga programi 16329	38,775.50	29,875.00	31,448.50	81.10	105.27
50016	1.1.2 Taksa certifikata tjera	38,775.50	29,875.00	31,448.50	81.10	105.27
50102	1.1.3 Gjobat e Gjykates					
50006	1.1.4 Taksa per regjistrim biznesi					
	1.2.Të hyrat nga programi 17529	722,976.53	411,855.59	546,185.56	75.55	132.62
40110	1.2.1 Tatimi ne Prone	595,992.97	300,135.89	430,993.84	72.32	143.60
50006	1.2.2 Taksa per regjistrim biznesi					
50408	1.2.3 Qiraja nga objektet publike	41,677.31	34,247.60	39,631.47	95.09	115.72
50029	1.2.4 Taksa për ushtrimin e veprimarive afariste	85,306.25	77,472.10	75,560.25		
	1.3.Të hyrat nga programi 18189	105,579.53	94,695.97	93,933.94	88.97	99.20
50001	1.3.1 Taksa regjistrim l automjeteve	73,330.00	77,700.50	82,013.00	111.84	105.55
50002	1.3.2.Taksa Rrugore	210.00	801.00	208.00	99.05	25.97
50104	1.3.3 Gjobat nga Inspektoriati	23,814.86	7,141.30	6,845.00	28.74	95.85
50204	1.3.4 Licenca per regjistrim biznesi	2,038.12	530.00	355.00	17.42	66.98
50290	1.3.5 Licenca tjera per afarizem	60.00			0.00	#DIV/0!
50405	1.3.6 Shfrytezim l prone publike	6,126.55	8,523.17	4,512.94	73.66	52.95
50505	1.3.7 Inspktimi veterinar brenda vendit			50.00		
	1.4. Të hyrat nga programi 47029	9,241.20	-	2,710.68		
50012	Taksa ndrrim destinac te tokes	9,241.20		2,710.68		
50214	Licenca per shfrytezimin e pyjeve					
50209	1.4.1 Licenca për shirje dhe korrije					
	1.5.Të hyrat nga programi 65145	80,546.50	59,599.00	60,792.00	75.47	102.00
50011	1.5.1 Taksa regjistrim l trashegimise	28,894.00	28,761.00	30,030.00	103.93	104.41
50019	1.5.2 Taksa tjera administrative	17,883.00	13,362.00	12,511.00	69.96	93.63
50504	1.5.3 Taksa për matjen e tokes ne teren	33,769.50	17,476.00	18,251.00	54.05	104.43
	1.6.Të hyrat nga programi 66450	84,192.10	25,610.70	59,115.00	70.21	230.82
50009	1.6.1 Taksa per leje ndertimi	81,936.75	21,616.00	51,552.00	62.92	238.49
50503	1.6.2 Insp.Respektimi Urbanistik	2,255.35	3,209.70	5,842.00	259.03	182.01

50026	Taksa për legalizimin e objekteve		785.00	1,721.00		219.24
	1.7.Të hyrat nga programi 74750	58,210.90	63,371.80	76,391.50	131.23	120.54
50409	1.7.1 Participimet	58,210.90	63,371.80	76,391.50	131.23	120.54
	1.8.Të hyrat nga programi 85029	7,762.85	567.00	509.00		89.77
50401	1.8.1 Shitja e Sherbimeve	650.50	567.00	509.00		89.77
50403	1.8.1 Te hyrat nga shitja e mallrave	7112.35				
	1.9.Të hyrat nga programi 92770,95040	48,376.00	47,950.00	53,521.00		111.62
50409	1.9.1 Participimet	48,376.00	47,950.00	40,161.00		83.76
	1.9.2 Participimet			13,360.00		
	1.10 Te hyrat nga viti I kaluar	625,687.54	697,875.67	408,555.27		
	61000	625,687.54	697,875.67	408,555.27		
	1. GJITHSEJ PRANIMET INDIREKTE	185,376.75	233,300.84	308,368.00		
	Gjobat ne trafik	140,308.10	207,668.00	196,452.00		
	Agjencioni Pyjor	44,668.65	16,317.84	49,960.00		
	Gjobat nga Gjykata	400.00	9,315.00	61,956.00		

Grafiku 1.Të hyrat vetanake për vitet 2023-2025

Të hyrat vetanake 2023-2025




Nga grafiku i mësipërm shohim arkëtimin e të hyrave vetanake për vitet 2023,2024 dhe 2025

Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të hyrat vetanake për vitin 2025 sipas programeve dhe llojit të të hyrave.

0	Përshkrimi	Janat	Shkurt	Mars	Pell	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Novitor	Dhjetor	2025
	1. GJITHSEJ PRANIMET DREKTE-INDIREKTE	68,464.15	71,904.90	119,943.07	137,782.98	158,972.86	89,346.50	88,486.24	123,282.50	125,016.64	100,346.73	57,848.30	91,630.50	1,233,025.37
	1. GJITHSEJ PRANIMET DREKTE	51,949.15	52,842.90	98,137.07	114,682.98	135,917.86	69,191.50	61,731.24	90,166.50	90,962.20	51,547.38	37,673.70	69,847.70	924,657.18
	1.1. Të hyrat nga programi 16329	2,542.00	1,916.50	2,269.00	2,468.00	2,195.00	2,296.50	3,058.00	3,017.00	4,396.50	2,205.50	1,894.00	3,190.50	31,448.50
50016	Taksa certifikata tjera	2,542.00	1,916.50	2,269.00	2,468.00	2,195.00	2,296.50	3,058.00	3,017.00	4,396.50	2,205.50	1,894.00	3,190.50	31,448.50
50403	Të Hyrat nga shifja e pasurisë	0.00	0.00	0.00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	1.2. Të hyrat nga programi 17529	15,062.36	28,244.30	44,779.39	88,480.68	104,302.56	41,726.55	32,115.24	57,591.00	59,024.20	21,124.88	14,289.70	39,444.70	546,185.56
40110	1.2.1. Tatimi ne Prone	9,557.97	24,249.86	33,651.89	78,760.68	87,010.71	23,960.70	36,061.24	41,069.50	48,885.20	15,485.88	10,067.95	32,292.26	430,993.84
50029	1.2.3. Taksa për ushritë veprimt. Afar.	1,165.00	980.00	7,357.50	9,270.00	11,882.50	12,610.00	3,200.00	13,667.50	7,285.00	2,785.00	1,347.75	4,010.00	75,560.25
50408	1.2.4. Qiraja nga objektet publike	4,339.39	3,014.44	3,770.00	510.00	5,409.35	5,155.85	2,854.00	2,854.00	2,854.00	2,854.00	2,874.00	3,142.44	39,631.47
	1.3. Të hyrat nga programi 18189	6,305.29	7,080.60	6,275.50	7,754.80	8,576.80	8,927.45	10,628.50	8,070.00	6,870.00	8,230.00	6,850.00	8,365.00	93,933.94
50001	1.3.1. Taksa regjistrim i automjeteve	5,335.00	5,000.00	5,435.00	6,278.00	6,060.00	7,575.00	10,130.00	7,265.00	6,780.00	7,880.00	6,285.00	7,990.00	82,013.00
50002	1.3.2. Taksa Rrugore	-	-	-	-	30.00	66.00	82.00	-	20.00	-	10.00	-	208.00
50104	1.3.3. Gjbat nga Inspektorati	275.00	425.00	600.00	100.00	2,250.00	1,250.00	325.00	400.00	50.00	300.00	495.00	375.00	6,845.00
50204	1.3.4. Licenca për regjistrim biznesi	0.00	80.00	60.00	40.00	55.00	-	20.00	60.00	20.00	20.00	-	-	355.00
50209	1.3.5. Licenca tjera për afarizem	0.00	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
50405	1.3.6. Shfrytëzim i pronës publike	695.29	1,575.60	180.50	1,336.80	181.80	36.45	71.50	345.00	30.00	30.00	60.00	-	4,512.94
	1.5. Të hyrat nga programi 65145	4,044.00	3,853.00	5,006.00	4,101.00	4,823.00	4,421.00	5,895.00	6,428.00	7,145.00	5,054.00	4,982.00	5,040.00	60,792.00
50019	1.5.2. Taksa tjera administrative	2,040.00	1,940.00	2,120.00	1,988.00	2,440.00	2,440.00	3,302.00	3,500.00	3,120.00	2,650.00	2,460.00	2,050.00	30,030.00
50011	1.5.2. Taksa regjistrim i trashigimis	711.00	701.00	1,285.00	1,192.00	916.00	634.00	969.00	1,214.00	1,130.00	1,037.00	784.00	1,938.00	12,511.00
50504	1.5.3. Taksa për mjetet e tokes ne teren	1,293.00	1,212.00	1,601.00	921.00	1,467.00	1,347.00	1,624.00	1,714.00	2,895.00	1,387.00	1,738.00	1,052.00	18,251.00
	1.6. Të hyrat nga programi 66450	6,494.00	1,976.50	29,289.00	2,561.50	884.00	3,522.50	1,030.00	4,213.00	2,018.50	5,693.00	180.00	1,253.00	59,115.00
50503	1.6.2. Insp. Respektime Urbanistik	70.00	70.00	120.00	80.00	60.00	751.00	120.00	70.00	40.00	80.00	180.00	80.00	1,721.00
50009	1.6.1. Taksa për leje ndërtimi	6,424.00	1,532.00	28,697.00	2,160.50	-	2,389.50	605.00	2,411.50	1,978.50	4,284.00	-	870.00	51,552.00
50026	Taxa për legalizimin e objekteve	0.00	374.50	472.00	321.00	824.00	182.00	305.00	1,731.50	-	1,329.00	-	303.00	5,842.00
	1.7. Të hyrat nga programi 74750	7,352.00	6,390.00	4,377.00	6,186.00	5,295.50	4,775.00	6,409.00	8,599.00	7,732.50	5,450.50	5,380.00	8,445.00	76,391.50
50409	1.7.1. Participimet (OKMF)	7,352.00	6,390.00	4,377.00	6,186.00	5,295.50	4,775.00	6,409.00	8,599.00	7,732.50	5,450.50	5,380.00	8,445.00	76,391.50
	1.8. Të hyrat nga programi 85029	94.00	50.00	12.00	15.00	-	33.00	30.00	127.50	13.00	27.00	30.00	77.50	509.00
50401	1.8.1. Shfite e Shërbimeve	94.00	50.00	12.00	15.00	-	33.00	30.00	127.50	13.00	27.00	30.00	77.50	509.00
	1.9. Të hyrat nga programi 92770-95040	10,055.50	3,339.00	3,418.50	3,066.00	9,841.00	3,489.50	2,565.50	2,121.00	3,762.50	3,762.50	4,068.00	4,032.00	53,521.00
50409	1.9.1. Participimet ARSIMI Teriturb	7,090.00	-	-	-	6,270.00	-	-	-	-	-	-	-	13,360.00
	1.9.2. Participimet Qerdhe	2,965.50	3,339.00	3,418.50	3,066.00	3,571.00	3,489.50	2,565.50	2,121.00	3,762.50	3,762.50	4,068.00	4,032.00	40,161.00
	1.4. Të hyrat nga programi 47029	-	-	2,710.68	50.00	-	-	-	-	-	-	-	-	2,760.68
50012	Taksa ndërrim destinac te tokes	-	-	2,710.68	50.00	-	-	-	-	-	-	-	-	2,710.68
50214	Licenca për shfrytëzimin e pyjeve	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
50209	1.4.1. Licenca për shfite dhe korje	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
50505	Të Hyrat nga Vëlerëtarja	-	-	-	50.00	-	-	-	-	-	-	-	-	50.00
	1. GJITHSEJ PRANIMET INDIREKTE	16,515.00	19,055.00	21,806.00	23,100.00	23,055.00	20,155.00	26,755.00	33,116.00	34,054.44	48,799.35	20,174.60	21,782.80	308,368.19
	Gjbat ne trafik	450.00	200.00	450.00	22,540.00	22,455.00	19,445.00	23,925.00	26,686.00	19,315.00	21,760.00	18,390.00	20,836.00	196,452.00
	Ajencioni Pjlor	-	-	-	-	-	-	2,400.00	6,000.00	14,659.44	26,379.35	474.60	46.80	49,960.19
	Gjbat nga Gjykata	16,065.00	18,855.00	21,356.00	560.00	600.00	710.00	430.00	430.00	80.00	660.00	1,310.00	900.00	61,956.00

Grafiku 2. Të hyrat vetanake 2025 sipas muajve



Në tabelën më sipër, mundë të krahasohen realizimi i shumave të të hyrave vetanake për vitin 2025 sipas muajve.

Siç mundë të shihet në muajin Nëntor ka qenë niveli më i ulët i realizimit ndersa në muajin Maj janë realizuar të hyra në nivelin më të lartë për vitin 2025.

Tabela 2.Realizimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike 2025

Përshkrimi	Buxheti Aktual	Alokuar	E paalokuar	Aktuali	Zotimet/obligimet e papaguara	Bilanci	Realizimi %
	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	E
11 PAGA DHE SHTESA	9,463,347.08	9,452,392.02	10,955.06	9,450,840.43	0.00	12,506.65	99.87
13 MALLRA DHE SHERBIME	2,455,403.95	2,454,707.92	696.03	2,347,995.56	95,673.68	11,734.71	95.63
14 SHPENZIME KOMUNALE	262,000.00	262,000.00	0.00	261,892.80	105.77	1.43	99.96
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	885,000.25	885,000.25	0.00	883,690.94	425.00	884.31	99.85
30 PASURITË JOFINANCIARE	2,963,032.92	2,913,032.92	50,000.00	2,668,033.33	133,018.11	161,981.48	90.04
38 REZERVAT	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Totali i përgjithshëm	16,028,784.20	15,967,133.11	61,651.09	15,612,453.06	229,222.56	187,108.58	97.40

Tabela 3. Buxheti sipas kategorive ekonomike 2024/2025

PERSHKRIMI	2024	2025	Progresi
11-Paga dhe Shtesa	10,765,928.07	9,463,347.08	87.90
13-Mallra dhe Sherbime	2,260,240.36	2,455,403.95	108.63
14-SHPENZIME KOMUNALE	254,423.16	262,000.00	102.98
20-SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	761,580.60	885,000.25	116.21
30-PASURITË JOFINANCIARE	3,001,254.68	2,963,032.92	98.73
TOTALI	17,043,426.87	16,028,784.20	94.05

Në tabelën 3. pasqyrohen të dhënat për buxhetin sipas kategorive ekonomike per vitin 2024 dhe 2025

Grafiku 3. Buxheti sipas kategorive ekonomike per vitin 2024/2025




Tabela 4.Financimi I buxhetit sipas fondeve burimore 2024/2025

Fondet Burimore	Janar-Dhjetor 2024	Janar- Dhjetor 2025	Krahasimi 2025/2024
Grandi Qeveritar	15,280,793.76	14,426,464.07	94.41
Te Hyrat Vetanake	1,016,620.39	1,134,072.01	111.55
Te hyrat e bartura 2024-2025	697,875.67	408,555.27	58.54
Donatorët e Brendshëm	45,057.61	53,013.41	117.66
Donatorët e Jahstëm	3,079.44	6,679.44	216.90
Totali	17,043,426.87	16,028,784.20	94.05

Grafiku 4. Financimi i buxhetit sipas fondeve burimore 2024-2025



Tabela 5. Shpenzimi i buxhetit sipas fondeve burimore 2024-2025

Fondet Burimore	Janar-Dhjetor 2024	Janar- Dhjetor 2025	Krahasimi 2025/2024
Grandi Qeveritar	14,426,726.00	14,252,852.47	98.79
Te Hyrat Vetanake	615,551.46	947,809.78	153.98
Te hyrat e bartura 2024-2025	640,594.84	390,342.81	60.93
Donatorët e Brendshëm	10,194.00	20,858.00	204.61
Donatorët e Jahstëm	-	590.00	0.00
Totali	15,693,066.30	15,612,453.06	99.49

Tabela 6. Lëvizja se buxhetit Janar-Dhjetor 2025

	Kategorit Ekonomike	Buxheti Fillestar	Te hyrat e bartura	Donatorët e Brendshëm	Donatorët e Jashtëm	Vendimi i Qeveris	Totali
1	Paga dhe Meditje	9,185,435.00	0.00			277,912.08	9,463,347.08
2	Mallra dhe Sherbime	2,422,098.00	31,701.95		1,604.00		2,455,403.95
3	Shpenzime Komunale	262,000.00					262,000.00
4	Subvencione dhe Transfere	885,000.00			5,075.44		890,075.44
5	Shpenzime Kpaitale	2,508,091.00	376,853.32	53,013.41			2,937,957.73
6	Rezerva	20,000.00					20,000.00
	Totali i përgjithshëm	15,282,624.00	408,555.27	53,013.41	6,679.44	277,912.08	16,028,784.20

Tabela 7. Realizimi i buxhetit ispas kategorive ekonomike 2024-2025

Përshkrimi	Janar-Dhjetor 2024	Janar- Dhjetor 2025	Krahasimi 2025/2024
Pagat dhe Mëditja	10,717,383.33	9,450,840.43	88.18
Mallra dhe Shërbime	2,000,815.58	2,347,995.56	117.35
Shpenzime Komunale	242,275.36	261,892.80	108.10
Subvencione	756,596.04	883,690.94	116.80
Investime Kapitale	1,975,995.99	2,668,033.33	135.02
Totali	15,693,066.30	15,612,453.06	99.49

Tabela 8. Shepnzimet sipas Kategorive ekonomike 2024-2025

Shepnzimet sipas Kategorive ekonomike 2024-2025			
Pagat	2024	2025	Krahasimi
11111 - PAGA NETO	6,537,755.74	7,320,990.61	111.98
11121 - TATIMI NË TË ARDHURAT PERSONALE	444,916.56	489,737.12	110.07
11131 - KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËTORI	402,212.48	449,756.05	111.82
11151 - SINDIKATAT	18,735.05	22,976.55	122.64
11152 - ODAT PROFESIONALE	5,356.89	6,037.17	112.70
11211 - PËRVOJA E PUNËS	361,441.18	406,491.82	112.46
11311 - KONTRIBUTI PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	402,212.48	449,992.15	111.88
11411 - SHITESA E VEÇANTË PËR TË ZGJEDHURIT	29,016.92	24,260.22	83.61
11416 - SHITESA PËR VËLLIMIN E PUNËS	5,196.98	8,913.57	171.51
11418 - SHITESA PËR NËPUNËSEN/IN E SISTEMIT SHËNDETËSOR	16,261.51	15,723.48	96.69
11431 - KUJD., PUNA GJATË NATËS & PUNA JASHTË ORARIT TË PUNËS	211,249.54	246,339.57	116.61
11611 - SHITESAT TRANZITORE	17,906.71	9,622.12	53.73
11900- PAGESA PER VENDIME GJYQSORE	2,265,121.29		-
TOTALI	10,717,383.33	9,450,840.43	88.18
Mallra dhe Sherbime			
13132 - AKOMODIMI PËR UDHËTIMET ZYRTARE BRENDA VENDIT	0.00	7,277.80	
13134 - TRANSPORTI PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	31,148.50		-
13140 - TRANSPORTI PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	13,856.47	12,945.87	93.43
13141 - PARA XHEPI/MËDITJET PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	1,934.52	3,076.00	159.01
13142 - AKOMODIM- UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VENDIT	576.00		-
13143 - SHPENZIMET E TJERA PËR UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VENDIT	1,858.00	11,948.40	643.08
13310 - INTERNETI	712.50	800.00	112.28
13320 - TELEFONIA MOBILE	699.85	648.66	92.69
13330 - SHËRBIMET POSTARE	6,963.11	9,374.80	134.64
13410 - SHËRBIMET E ARSIMIT DHE TRAJNIMIT	0.00	1,687.00	#DIV/0!
13420 - SHËRBIMET E PËRFAQËSIMIT PËR AVOKATURË	15,898.25	16,093.25	101.23
13430 - SHËRBIMET E NDRYSHME SHËNDETËSORE	17,191.92	23,139.90	134.60
13440 - SHERBIMET KESHILLDHENESE DHE PROFESIONALE	5,516.58		-
13445 - SHËRBIMET E VEÇANTA - KONSULENTË DHE KONTRAK. IND.	170,715.74	193,386.58	113.28
13450 - SHËRBIMET E SHËNDETËSORE	8,846.50	15,379.77	173.85

13460 - SHËRBIMET KONTRAKTUESE TË TJERA	307,418.16	455,577.60	148.19
13470 - SHËRBIMET TEKNIKE	95,898.53	75,566.39	78.80
13471 - SOFTUERËT - LICENCAT DHE MIRËMBAJTJA E TYRE	0.00	240.00	
13480 - SHPENZIMET E ANËTARËSIMIT	6,912.75	1,500.00	21.70
13501 - MOBILJET	19,981.00	11,617.99	58.15
13503 - KOMPJUTERËT		16,447.00	
13504 - PAJISJET E TJERA TË TEKNOLOGJISË INFORMATIVE DHE TË KOMUNIKIMIT	54,667.50	37,729.85	69.02
13509 - PAJISJET E TJERA	167,463.31	91,182.19	54.45
13610 - FURNIZIMET PËR ZYRË	71,661.61	32,665.83	45.58
13620 - FURNIZIMI ME USHQIM DHE PIJE (JO DREKA ZYRTARE)	55,657.20	47,219.02	84.84
13630 - FURNIZIMET MJEKËSORE	110,469.98	74,983.08	67.88
13640 - FURNIZIMET E PASTRIMIT	13,384.10	17,551.89	131.14
13650 - FURNIZIMI ME VESHMBATHJE	56,606.78	35,652.00	62.98
13660- AKOMODIMI	1,440.00		-
13720 - NAFTA PËR NGROHJE QENDRORE	6,804.83	3,929.31	57.74
13760 - DRUTË DHE PRODHIMET E DRURIT PËR NGROHJE	73,512.25	76,674.36	104.30
13780 - DERIVATET PËR AUTOMJETE, GJENERATORË DHE MAKINERI	47,188.73	45,121.34	95.62
13950 - REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	3,490.00	4,035.00	115.62
13951 - SIGURIMI I AUTOMJETEVE	9,259.89	9,184.99	99.19
13954 - KONTROLLIMI TEKNIK I AUTOMJETEVE	1,064.00	1,107.00	104.04
14010 - MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE	21,628.89	24,933.14	115.28
14020 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE TË BANIMIT	6,903.80	8,922.00	129.23
14022 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ADMINISTRATIVE DHE AFARISTE	20,584.27	9,316.02	45.26
14023 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE ARSIMORE	152,694.46	132,798.52	86.97
14023 - MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE SHENDETSORE	1,428.50		-
14030- MIRËMBAJTJA E AUTORRUGEVE	981.00		-
14032 - MIRËMBAJTJA E RRUGËVE LOKALE	101,716.65	211,595.80	208.02
14040 - MIRËMBAJTJA E TEKNOLOGJISË INFORMATIVE	1,590.00		-
14050 - MIRËMBAJTJA E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE	11,360.40	12,149.19	106.94
14060 - MIRËMBAJTJA RUTINORE	115,262.03	166,410.66	144.38
14220 - BOTIMET E PUBLIKIMEVE	462.00	2,997.00	648.70
14310 - KOMPENSIMI I PËRFAQËSIMIT BRENDIA VENDIT	22,647.10	18,910.77	83.50
14410 - VENDIMET GJYQËSORE	164,710.25	426,219.59	258.77
14415- PAGESA PËR TARIFA-VENDIMET GJYQËSORE PËRMBARIMORE	47.67		-
Totali	2,000,815.58	2,347,995.56	117.35
Shpenzime Komunale			

13210 - ENERGJIA ELEKTRIKE	203,855.54	221565.5	108.69
13220 - SHËRBIMET E UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT	13,604.53	11454.11	84.19
13230 - MBETURINAT	17,921.73	15627.3	87.20
13250 - TELEFONIA FIKSE	6,893.56	5853.49	84.91
13260 - PAGESAT - VENDIME GJYQËSORE	0.00	7392.4	
Totali	242,275.36	261892.8	108.10
Subvencionet			
21110 - SUBVENCIONET PËR ENTITETET PUBLIKE	76,377.00		-
21200 - SUBVENCIONET PËR ENTITETET JOUBLIKE	354,456.09	320,983.88	90.56
22202 - TRANSFERET PËR PËRFITUES INDIVIDUAL TJERË	292,806.30	304,076.75	103.85
22298 - PAGESAT PËR SHËRBIMET E VARRIMIT	20,630.00	17,280.00	83.76
22300 - VENDIMET GJYQËSORE	12,326.65	241,350.31	1,957.96
Totali	756,596.04	883,690.94	116.80
Investimet Kapitale			
31110- NDËRTESA BANIMI	58,667.80		-
31120 - NDËRTESAT ADMINISTRATIVE DHE AFARISTE	42,499.97	74,325.50	174.88
31121 - NDËRTESAT ARSIMORE	123,857.54	8,960.00	7.23
31121 - NDËRTESAT SHËNDETSORE	23,253.42		-
31123 - OBJEKTE KULTURORE	5,000.00		-
31124 - OBJEKTET SPORTIVE	10,500.00	20,000.00	190.48
31125 - MONUMENTET DHE KOMPLEKSET MEMORIALE	0.00	4,214.25	
31129 - FUSHAT SPORTIVE	77,222.28	22,702.04	29.40
31136 - URAT	157,592.12	23,470.00	14.89
31230 - RRUGËT LOKALE	646,146.76	1,480,327.14	229.10
31240 - TROTUARET	138,579.70	60,999.70	44.02
31250 - RRJETET E KANALIZIMIT	259,063.71	72,736.61	28.08
31260- RRJETET E UJËSJELLSIT	160,000.00		-
31510- PAISJET E GJENERIMIT TË ENERGJ. ELEK. DHE NDRIQIMIT PUBLIK	18,206.09		-
31690 - PAJISJET E TJERA	14,897.00	18,294.70	122.81
31700- VETURA ZYRTARE	41,065.00		-
31703 - VETURAT E NDIHMËS SË SHPEJTË	0.00	69,900.00	
32111 -SISTEMET E UJITJES	5,609.50		-
32140 - PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE	131,731.00	86,545.19	65.70
34000 - PAGESAT SIPAS VENDIMEVE GJYQËSORE	62,104.10	725,558.20	1,168.29
	1,975,995.99	2,668,033.33	135.02
Bilanci i përgjithshëm		15,612,453.06	99.49

	15,693,066.30		
--	---------------	--	--

Neni 17 Raport për detyrimet (faturat) e papaguara

	2025		2024		2023	
Kategoria ekonomike	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë
Paga dhe shtesa		125,891.15		1,005,323.83		404,553.26
Mallra dhe shërbime	77,960.65	23,072.95	42,905.33		28,380.56	4,168.74
Shpenzime komunale	30,766.64		14,727.31		5,168.14	
Transfere dhe subvencione	44,150.00	100,100.00	15,206.90	7,980.00	22,150.00	7,800.00
Shpenzime kapitale	22,320.80	51,660.96	26,070.00			
	<u>175,198.09</u>	<u>300,725.06</u>	<u>98,909.54</u>	<u>1,013,303.83</u>	<u>55,698.70</u>	<u>416,522.00</u>

Neni 18 Detyrimet kontingjente

Kategoritë ekonomike	2025	2024	2023
Paga dhe shtesa	928587.6	1,435,526.04	1,245,504.85
Mallra dhe shërbime	15,790.00	19,290.00	46,565.70
Shpenzimet komunale			
Subvencione dhe Transfere			167,300.00
Shpenzimet kapitale	762,899.06	587,568.23	439,149.51
	<u>1,707,276.66</u>	<u>2,042,384.27</u>	<u>1,898,520.06</u>

Neni 25 Rexhistri i punëtorëve sipas listës së pagave

Departamenti	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit	Nr aktual i punëtorëve në fund të 2025		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2024		Nr aktual i punëtorëve në fund të 2023	
		Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar	Me orar të plotë	Me orar të shkurtuar
Zyra e Kryetarit	29	24		28		24	
Adminitrata	35	34		34		33	
Qeshtja Gjimore	1	1				1	
Zyra e KK	27	27		27			
Buxhetimi	25	21		21		22	
Infrastruktura Publike	20	17		21		17	
Menaxhimi i Katastrofave						5	
Zjarrfikësit dhe Inspektim	33	29		29		32	
ZLK	7	7		7		7	
Bujqësia	9	8		8		18	
Planifikimi i zhvillimit eko	5	5		5		5	
Sherbimet Kadastrale	11	10		11		10	
Planifikimi Urban dhe Ins	10	7		8		9	
Planifikimi Mjedisor dhe l	6	4					
Adminitrata	4	4		3		4	
Sherbimet e Shëndetësis P	161	152		149		153	
Sherbimet Sociale	13	11		13		12	
Sherbimet Rezidenciale	11	11		11		10	
Sherbimet Kulturore	18	18		19		21	
Perkrahja e Rinisë	3	2					
Adminstrata Arsim	12	10		9		8	
Arsimi Parashkollor	46	47		36		32	
Arsimi Fillore I Mesëm I U	496	475		495		508	
Arsimi I Mesëm I lartë	172	147		160		173	
Gjithsej	1,154	1,071	-	1,094	-	1,104	

Neni 21 Raport mbi të hyrat vetanake të pa shpenzuara

Përshkrimi	2025	2024	2023
Të hyrat vetanake të bartura nga viti i kaluar	408,555.27	697,875.67	625,687.54
Të hyrat e pranuar në këtë vit	1,072,420.92	739,083.57	1,155,611.11
Totali në dispozicion për ndarje në vitin aktual	1,480,976.19	1,436,959.24	1,781,298.65
Shuma e shpenzuar në vitin aktual	1,338,152.59	1,256,146.30	
Bilanci për bartje	142,823.60	180,812.94	697,875.67

Mbetja për të hyra të bartura për vitin 2026 nga të hyrat vetanake 2025 dhe nga të hyrat e bartura 2024 është 142,823.60

duke mos llogaritur të hyrat indirekte

Shpalosja :Të hyrat totale për vitin 2025	924,657.23
Te hyrat e bartura 2024	408,555.27
Te hyrat indirekte	304,398.19
Totali i të hyrave	1.637,610.69
Shpenzimet nga të hyrat 2025	947,809.78
Shpenzimet nga të hyrat 2024	390,342.81
Totali i shpenzimeve	1,338,152.59
Totali për bartje në vitin 2026	299,458.10

Tabela 9. Projektet kapitale nga fondi burimor 10

Përshkrimi	Buxheti	Shpenzimet	Zotimet/oblig- e papaguara	Buxheti i mbetur	Realizimi në %
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAMENICË
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Bllatë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m ²
P-71107004-00003-0	Parcelë / Parcela / Parcel	42560



Shkalla/Razmera/Scale: 1:4591

Punoi/Obradio/Created: Syhana Latifaj

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 29.01.2026

Koha/ Vreme/ Time: 11:29:27



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : KAMENICË

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Bilatë

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-71107004-00002-0	Parcelë / Parcela / Parcel	13750



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2091

Punoi/Obradio/Created: Syhana Latifi

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:




Data/ Data/Date: 29.01.2026

Koha/ Vreme/ Time: 11:27:37



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/2008), neni 84 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, nenit 12 paragrafi 1 pika 1.6 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 për metodologjinë e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, Vendimi Sh. 02.Nr. 20609, i datës 26.06.2024, për themelimin e Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, i plotësuar dhe ndryshuar me Vendimin Sh. 02.Nr. 20290, të datës 29.07.2025., si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Kamenicës, Sh. 01.Nr. 20203, datë 21.06.2023, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2026, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për miratimin e raporteve të Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera

1. Me këtë vendim miratohen raportet e Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë raportet e Komisionit Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si në vijim:
 - 2.1. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6104, i datës 09.03.2026;
 - 2.2. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6082, i datës 09.03.2026;
 - 2.3. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6083, i datës 09.03.2026;
 - 2.4. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6087, i datës 09.03.2026;
 - 2.5. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6088, i datës 09.03.2026;
 - 2.6. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6091, i datës 09.03.2026;
 - 2.7. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6093, i datës 09.03.2026;
 - 2.8. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6094, i datës 09.03.2026;
 - 2.9. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6095, i datës 09.03.2026;
 - 2.10. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6097, i datës 09.03.2026;
 - 2.11. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6098, i datës 09.03.2026;
 - 2.12. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6099, i datës 09.03.2026;
 - 2.13. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6103, i datës 09.03.2026;
 - 2.14. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6100, i datës 09.03.2026;
 - 2.15. Raporti nga vlerësimi i dëmit, Sh. 01.Nr. 6102, i datës 09.03.2026;

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike, Ambient, Inspektorat dhe Emergjencia në Komunën e Kamenicës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- DSHPAIE - së;
- Arkivit.


Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 7 paragrafi 7.3, neni 13 dhe neni 58 shkronja h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr.28, publikuar me 4 qershor 2008), neni 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe neni 3 paragrafi 3.3, 3.4, 3.5, neni 70, paragrafi 70.1, shkronja h) dhe neni 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës që mbahet më _____ 2026 sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR INICIMIN DHE ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE DHE VLERËSIMIN E PROPOZIMEVE PËR NDRYSHIMIN E STEMËS SË KOMUNËS SË KAMENICËS

1. Miratohet formimi i Komisionit për iniciimin dhe zhvillimin e procedurave dhe vlerësimin e propozimeve për ndryshimin e Stemës së Komunës së Kamenicës.
2. Komisioni është organ i përkohshëm me mandat të përcaktuar, i cili ushtron kompetenca për zhvillimin e procesit deri në paraqitjen e rekomandimit përfundimtar në Kuvendin e Komunës.
3. Komisioni do të ketë këtë përbërje:
 - 3.1. _____ (nga Kuvendi i Komunës)
 - 3.2. _____ (nga Kuvendi i Komunës)
 - 3.3. _____ (nga Kuvendi i Komunës)
 - 3.5. Afrim Dervishi, (nga Ekzekutivi i Komunës);
 - 3.6. Valdete Berisha Murina (Zyra e Informimit); dhe
 - 3.7. Lavdim Klaiqi (nga shoqëria civile/OJQ).
4. Komisioni ka mandat që:
 - 4.1. Të iniciojë dhe zhvillojë procedurat për ndryshimin e Stemës së Komunës së Kamenicës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - 4.2. Të analizojë aspektin ligjor, historik, kulturor dhe simbolik të stemës.
 - 4.3. Të hartojë planin e veprimit, kriteret dhe standardet për procesin e ndryshimit të stemës.

- 4.4. Të organizojë konsultime publike dhe forma të tjera të përfshirjes së qytetarëve në proces.
- 4.5. Të përgatisë dhe shpallë thirrje apo konkurs publik për pranimin e propozimeve për stemën e re.
- 4.7. Të pranojë dhe administrojë propozimet e paraqitura.
- 4.8. Të kryejë vlerësimin profesional të propozimeve në bazë të kritereve, duke përfshirë:

- 4.8.1. përputhshmërinë ligjore,
- 4.8.2. elementet heraldike,
- 4.8.3. identitetin historik dhe kulturor,
- 4.8.4. përfaqësimin institucional,
- 4.8.5. cilësinë estetike dhe grafike.

- 4.9. Të angazhojë ekspertë dhe konsulentë të jashtëm nga fushat relevante, me qëllim sigurimin e mbështetjes profesionale dhe teknike gjatë procesit të shqyrtimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së propozimeve.
- 4.10. Të përgatisë raport përfundimtar me rekomandim të arsyetuar për Kuvendin e Komunës lidhur me propozimin për stemën e re.

5. Mënyra e Punës dhe Vendimmarrja

- 5.1. Kryesuesi i Komisionit zgjidhet në mbledhjen e parë nga radhët e anëtarëve të Komisionit.
- 5.2. Komisioni punon në mbledhje të rregullta të thirrura nga Kryesuesi.
- 5.3. Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë shumica e anëtarëve.
- 5.4. Komisioni vendos me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve prezentë.
- 5.5. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal.
- 5.6. Procesi i vlerësimit dokumentohet me raport të arsyetuar.

6. Transparenca dhe Konflikti i Interesit

- 6.1. Komisioni është i obliguar që procesin ta zhvillojë në mënyrë transparente dhe të dokumentuar.
- 6.2. Anëtarët e Komisionit nuk mund të marrin pjesë në vlerësimin e propozimeve në rast konflikti interesi.
- 6.3. Çdo anëtar është i obliguar të deklarojë konfliktin e mundshëm të interesit para fillimit të procesit të vlerësimit.

- 7. Komisioni do të përfundojë punën dhe do të paraqesë raportin përfundimtar me rekomandim në Kuvendin e Komunës.

8. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës përmes Komisionit të formuar sipas këtij vendimi.
9. Ky vendim, pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe legjislacionit përkatës në fuqi, si dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i`u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Anëtarëve të Komisionit; dhe
- QSHQ - Arkivit.



Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA KAMENICA MUNICIPALITY	
QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA FOR SERVICES WITH CITIZENS	
SH./Z./IS. 02	Nr./Br./No. 6486
Nr. i fletës Br. Str. No. Pg. 3	Data Datum Date 12/10/2026
KAMENICË - KAMENICA	



Zyra e Kryetarit

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58, shkronja h), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28, datë 4 qershor 2008), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në përputhje me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi, neni 7 të Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 04, datë 19 mars 2012), Ftesës Publike Sh.02.Nr.3177, datë 04.02.2026, për propozimin e anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), si dhe nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja h) dhe nenit 82 të Statutit të Komunës së Kamenicës, Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023, me qëllim të themelimit dhe funksionalizimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, që mbahet më _____ 2026, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - KKSBB

1. Me këtë vendim themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi i Komunës së Kamenicës (në tekstin e mëtejshëm: KKSBB), me qëllim të forcimit të sigurisë publike, bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përfshirjes së komuniteteve në çështjet e sigurisë, në përbërje si vijon:
 - 1.1. Kadri Rahimaj, Kryetar i Komunës – Kryesues i KKSBB-së;
 - 1.2. Ymërdin Hasani, përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës;
 - 1.3. Basri Shkodra, Komandant i Stacionit Policor;
 - 1.4. Hyrmete Morina, përfaqësuese e personave me aftësi të kufizuara – Handikos;
 - 1.5. Bujar Fera, përfaqësues i Bashkësisë Islame;
 - 1.6. Srdjan Milenkovic, përfaqësues i Kishës Ortodokse;
 - 1.7. Ramiz Kryeziu, përfaqësues i Komunitetit Etnik Rom;
 - 1.8. Sherafedin Vranja, përfaqësues i Organizatës së Shoqërisë Civile (OJQ);
 - 1.9. Lavdim Klaiqi, përfaqësues i Medias Lokale;
 - 1.10. Petrit Krasniqi, përfaqësues i Komunitetit të Biznesit;
 - 1.11. Ivan Markovic, Kryesues i Komitetit për Komunitete të Kuvendit të Komunës;
 - 1.12. Kosovare Maroca Berisha, Zyrtare për Barazi Gjinore;
 - 1.13. Selami Klaiqi, Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit;
 - 1.15. Nazmije Demolli Kastrati, Kryetare e Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës;
 - 1.16. Selami Spahiu, Përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike;

1.17. Fisnik Kastrati, Kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;

1.18. Florentina Kryeziu, Përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale; dhe

1.19. Bajrush Krieziu, Përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

2. Në rast të mungesës së Kryesuesit në ndonjë takim, drejtimin e takimit e merr Nënkryetarja e Komunës, e cila ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të KKSB-së.
3. KKSB-ja mban së paku gjashtë (6) mbledhje në vit, prej të cilave tri (3) duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit kalendarik. KKSB-ja mund të mbledhet edhe më shpesh, sipas nevojës ose me kërkesë të Kryesuesit apo të anëtarëve të saj.
4. Mandati i anëtarëve të KKSB-së zgjat aq sa mandati i anëtarëve të Kuvendit Komunal.
5. Detyrat, përgjegjësitë, organizimi i mbledhjeve dhe çështjet e tjera që lidhen me funksionimin e KKSB-së rregullohen me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi.
6. Kuvendi Komunal, me propozimin e Kryesuesit të KKSB-së, vendos për zëvendësimin e anëtarit që nuk përmbush detyrat e tij, mospjesëmarrës në tri (3) takime radhazi, ose vepron në mënyrë që cenon funksionimin efektiv të KKSB-së, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas dërgimit te autoriteti mbikëqyrës, MAPL, dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Ky Propozim - Vendim mbështetet në nenin 13 dhe nenin 58, shkronja h), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28, datë 4 qershor 2008), në nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi, neni 7 të Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë, Ky propozim mbështetet, ndër të tjera, edhe në Ftesën Publike Sh.02.Nr.3177, datë 04.02.2026, të shpallur për realizimin e procedurës së propozimit të anëtarëve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), si dhe në nenin 70, paragrafi 70.1, shkronja h) dhe nenin 82 të Statutit të Komunës së Kamenicës, Sh.01.Nr.20203, datë 21.06.2023.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) është një mekanizëm lokal bashkëpunues, i krijuar me qëllim të rritjes së sigurisë publike dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve komunale, organeve të rendit dhe komunitetit. Përmes funksionimit të tij synohet adresimi i koordinuar i çështjeve që lidhen me sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve, si dhe

identifikimi dhe trajtimi me kohë i sfidave të sigurisë në nivel lokal, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duke marrë parasysh bazën ligjore dhe rëndësinë e funksionalizimit të këtij mekanizmi, propozohet miratimi i këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës.

Vendimi i`u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Anëtarëve të Këshillit; dhe
- QSHQ - Arkivit.



Kryetari i Komunës
Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kaancelarija Predsednika

Na osnovu člana 13 i 58, slovo h), Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 (Službeni List Republike Kosova br. 28, od/datum 4 juni 2008), člana 44 Zakona o Opštem Upravnom Postupku Br. 05/L-031, u skladu sa odredbama Administrativnog Uputstva o Opštinskim Savetima za Bezbednost u Zajednici Br. 27/2012 MUP-03/2012 MALS-a, član 7 Zakona o Policiji Br. 04/L-076 (Službeni List Republike Kosova, Br. 04, od/datum 19 mart 2012), Javnog Poziva o predlogu članova Opštinskog Saveta za bezbednost u Zajednici, (OSBZ-e), kao i člana 70, stav 70.1, slovo h) i člana 82 Statuta Opštine Kamenica, Š 01, Br.20203 od/datum 21.06.2023, ciljem osnivanja i funkcionisanja Opštinskog Saveta za Bezbednost u Zajednici (OSBZ-e), Predsednik Opštine, za redovnu sednicu Skupštine Opštine Kamenica, koja će se održati _____ 2026, donosi ovu:

PREDLOG ODLUKE

ZA OSNIVANJE OPŠTINSKOG SAVETA ZA BEZBEDNOST U ZAJEDNICI - OSBZ

1. Ovom odlukom osnovan Opštinski Savet za Bezbednost u Zajednici Opštine Kamenica (u daljem tekstu: OSBZ), ciljem jačanja javne bezbednosti, međuinstitucionalne saradnje i uključivanja zajednica po pitanju bezbednosti u sledećem sastavu:

- 1.1. Kadri Rahimaj, Predsednik Opštine – Predsedavajaci OSBZ-e;
- 1.2. Ymërdin Hasani, predstavnik Kosovskih Bezbednosnih Snaga;
- 1.3. Basri Shkodra, Komandir Policijske Stanice;
- 1.4. Hyrmete Morina, predstavnica osoba sa invaliditetom - Handikos;
- 1.5. Bujar Fera, predstavnik Islamske Zajednice;
- 1.6. Srdan Milenković, predstavnik Pravoslavne Crkve;
- 1.7. Ramiz Kryeziu, predstavnik Romske Etnicke Zajednice;
- 1.8. Sherafedin Vranja, predstavnik Organizacije Civilnog Društva (NVO);
- 1.9. Lavdim Klaiqi, predstavnik Lokalnih Medija;
- 1.10. Petrit Krasniqi, predstavnik Poslovne Zajednice;
- 1.11. Ivan Marković, Predsedavajuci Komiteta za Zajednice Skupštine Opštine;
- 1.12. Kosovare Maroca Berisha, Sluzbenica za Rodnu Ravnopravnost;
- 1.13. Selami Klaiqi, Direktor Opštinskog Odeljenja Obrazovanja;
- 1.15. Nazmije Demolli Kastrati, Predsednik Roditeljskog Saveta za Obrazovanje Opštine;
- 1.16. Selami Spahiu, Predstavnik svakog Lokalnog Saveta za Bezbednost u Zajednici;
- 1.17. Fisnik Kastrati, Predsedavajuci Tim za Bezbednost u Zajednici;

1.18. Florentina Kryeziu, Predstavnik iz Sektora Vabrednih građanskih situacija opštine; i

1.19. Bajrush Krieziu, Predstavnik Opštinske Kancelarije za Zajednice i Povratak.

2. U slučaju odsustva Predsedavajućeg na nekom od bilo kojeg sastanka, sastankom predsedava Potpredsednica Opštine, koja obavlja sva prava i odgovornosti Predsedavajućeg OSBZ-e.
3. OSBZ-e godišnje održava najmanje šest (6) sastanka, od kojih tri (3) treba održati u prvo šestomesečje kalendarske godine. OSBZ-e može se i češće sastati, po potrebi ili na zahtev Predsedavajućeg ili njegovih članova.
4. Mandat članova OSBZ-e traje koliko i mandat odbornika Skupštine Opštine.
5. Dužnosti, odgovornosti, organizovanje sastanaka i drugih pitanja vezano funkcionisanja OSBZ-e reguliše se odredbama Administrativnog Uputstva br. 27/2012 MUP-03/2012 MALS o Opštinskim Savetima za Bezbednost u Zajednici.
6. Skupština Opštine na predlog Predsedavajućeg OSBZ-e, odlučuje za zamenu člana koji ne ispunjava njegove zadatke, neučestvovanje na tri (3) redovna sastanka, ili deluje na način ugrožavanja efektivnog funkcionisanja OSBZ-e, u skladu sa važećim zakonima.
7. Nakon usvajanja od Skupštine Opštine Kamenica, ova odluka stupa na snagu 15 (petnaest) dana nakon slanja nadzornom organu MALS-a, i 7 (sedam) dana nakon objavljivanja na službenoj veb Opštinskoj stranici.

Obrazloženje

Ova Predlog Odluka zasnovan na član 13 i na član 58, slovo h), Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br. 03/L-040 (Službeni List Republike Kosova, br. 28, od/datum 4 juni 2008), na član 44 Zakona o Opštem Upravnom Postupku Br. 05/L-031, kao i odredaba Administrativnog Uputstva o Opštinskim Savetima za Bezbednost u Zajednici Br. 27/2012 MUP-03/2012 MALS, člana 7 Zakona o Policiji Br. 04/L-076, Ovaj poziv se oslanja, među ostalog i na Javni Poziv Š. 02, Br. 3177, od/datum 04.02.2026, koji je objavljen za realizaciju postupka članova Opštinskog Saveta za Bezbednost u Zajednici (OSBZ), kao i na član 70, stav 70.1, slovo h) i član 82 Statuta Opštine Kamenica, Š 01, Br. 20203, od/datum 21.06.2023.

Opštinski Savet za Bezbednost u Zajednici (OSBZ) je lokalni mehanizam saradnje, formiran ciljem povećanja javne bezbednosti i jačanja saradnje između opštinskih institucija, organa reda zajednice. Kroz njegovo funkcionisanje, teži se koordinirano adresovanje o pitanjima koja su ~~vezana za javnu bezbednost i dobrobit građana~~, kao i identifikacijom i blagovremenom obradom izazova na lokalnom nivou u skladu sa važećim zakonodavstvom.

Obzirom na pravni osnov i važnost činjenja ovog mehanizma operativnim, predlaže se usvajanje ove odluke od strane Skupštine Opštine Kamenica.

Odluku slati:

- *Kancelariji Predsednika;*
- *Supštinskoj Službi;*
- *Kancelariji Prevođenja;*
- *Članovima Saveta; i*
- *CGU - Arhivi.*




Predsednik Opštine

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika e Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Në bazë të nenit 13, nenit 17, shkronja o), nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja i) dhe nenit 58, shkronja h), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28, 15 qershor 2008), nenit 7 dhe nenit 24 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, në bazë të nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja o), nenit 38, paragrafi 38.2, shkronja l), nenit 70, paragrafi 70.1, shkronja b), dhe nenit 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, si dhe duke u bazuar në Propozimin Sh.02.Nr.6518, të datës 12.03.2026, të Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për emërtimin e Palestrës së Sportit në Kamenicë, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, e cila mbahet më _____ 2026, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM për emërtimin e Palestrës së Sportit në Kamenicë

1. Miratohet propozimi për emërtimin e Palestrës së Sportit në Kamenicë me emrin: "Palestra e Rinisë dhe Sporteve 'Vëllezërit Krivaqa'".
2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria e Administratës së Përgjithshme.
3. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport obligohet të ndërmarrë veprimet e nevojshme për vendosjen e shenjëse identifikuese (tabelës) me emërtimin e ri të objektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës së Kamenicës.

Arsyetim

Më 19 qershor 1999, një ditë pas çlirimit të Komunës së Kamenicës, ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Sabri Krivaqa dhe Driton Krivaqa, së bashku me bashkëluftëtarin e tyre Agush Isufi, humbën jetën në rrethana tragjike në afërsi të Urës së Madhe në lagjen "Malësia" në Kamenicë. Rënia e tyre ndodhi gjatë angazhimit të tyre në shërbim të lirisë dhe në përpjekje për mbrojtjen e qytetarëve në periudhën menjëherë pas çlirimit të qytetit.

Sakrifica dhe kontributi i tyre në luftën çlirimtare përbëjnë një pjesë të rëndësishme të historisë dhe kujtesës kolektive të qytetarëve të Komunës së Kamenicës dhe mbeten një dëshmi e përkushtimit për lirinë dhe të ardhmen e vendit.

Me qëllim të nderimit dhe përjetësimit të kujtimit dhe kontributit të tyre, si dhe për të promovuar vlerat e lirisë, solidaritetit dhe përgjegjësisë qytetare tek brezat e rinj, propozohet që Palestra e Sportit në Kamenicë të emërtohet “Palestra e Rinisë dhe Sporteve ‘Vëllezërit Krivaqa’”. Ky emërtim paraqet një shenjë respekti dhe mirënjohjeje institucionale për veprën dhe sakrificën e tyre.

Vendimi i`u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Shërbimit të Kuvendit;
- Zyrës së Përkthimeve;
- Drejtorive Komunale; dhe
- QSHQ - Arkivit.

